



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1976/4 prot.

Datë 07.08.2026

V E N D I M

Nr. 950/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Urdhër për pezullimin e shqyrtimit administrativ të ankimit elektronik, me nr. nr. A/2026/6844, datë 18.06.2026, protokolluar me nr. 1976/2026 prot, datë 19.06.2026 e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me nr.REF-88936-06-05-2026, me objekt: “*Furnizim vendosje e sistemit të dedektimit të zjarrit në pyje*”, me fond limit 27,421,733 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 08-07-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

Subjekte të Interesuar: Bashkia Elbasan.
Rruga Qemal Stafa, Elbasan

Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK me NUIS K21710002J dhe adresë: Rr. Murat Toptani, Eurocol Center, Tirane.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 08-06-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me nr.REF-88936-06-05-2026, me objekt: “*Furnizim vendosje e sistemit të dedektimit të zjarrit në pyje*”, me fond limit 27,421,733 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 08-07-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

I.2. Në datën 18.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6844, protokolluar me nr. 1976/2026 prot, datë 19.06.2026 e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

I.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

I.4. Në datën 29.06.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 21976/1 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues me objekt: “*Kundershtime ndaj Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan percjelle me shkresen nr. 2898/5, date 24.06.2026*”, ku thuhet shprehimisht si vijon:

“*Nga përmbajtja e Vendimit të KSHA-së percjelle me shkresen nr. 2898/5, date 24.06.2026, rezulton se ankesa e OE-së nuk është marrë në shqyrtim, me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimit.*

Konkretisht, KSHA shprehet se, në zbatim të:

(i) nenit 110, pikat 1, 7 dhe 8, “Afatet për ankimim”, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”;

(ii) nenit 97, pika 1, germa “a”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021; afati i ankimit për këtë procedurë, e cila klasifikohet “mbi kufirin e lartë monetar”, është 10 ditë, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Kundërshtim:

Aktualisht, njoftimi i kontratës mban datën 08.06.2026, ndërsa ankimi i OE-së është dorëzuar më datë 18.06.2026, fakt ky i konfirmuar edhe nga vetë KSHA.

Nëse arsyetimi i KSHA-së ka qenë se afati i ankimit duhet të fillonte nga momenti i publikimit të njoftimit dhe jo nga dita pasardhëse, sqarojmë se çështja e nisjes së afateve të ankimit është

tashmë ezaauruar përmes qëndrimeve unifikuese të Komisionit të Prokurimit Publik. Ky i fundit është shprehur qartësisht se “afatet e ankimit nisin nga e nesërmja e datës së publikimit”. Për referencë, mund të konsultohet Vendimi Interpretues i KPP-së nr. 169/2026, paragrafët III.1.12 dhe III.1.13, faqe 15-16.

Kërkesë:

Kujtojmë se mekanizmi i shqyrtimit të ankesave në një procedurë prokurimi publik bazohet në një sistem vlerësimi me dy shkallë administrative.

Shkalla e parë konsiston në shqyrtimin e ankesës nga vetë strukturat përgjegjëse/eprore të autoritetit kontraktor, konkretisht Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (Neni 114 i LPP);

dhe Shkalla e dytë konsiston në shqyrtimin e ankesës, si dhe të vlerësimit të bërë mbi të nga autoriteti kontraktor/KSHA, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik (Neni 115 i LPP).

Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka rrëzuar ankimin për arsye procedurale, konkretisht për tejkalim të afatit të ankimit, vlerësim ky që është në kundërshtim me ligjin dhe praktikën interpretuese të KPP-së, si dhe nuk ka marrë në shqyrtim të gjithë elementët përbërës dhe pretendimet materiale të ankesës, gjykojmë se Komisioni i Prokurimit Publik duhet fillimisht ta kthejë ankimin për shqyrtim të detyrueshëm pranë autoritetit kontraktor.

Vetëm pas administrimit të qëndrimit të autoritetit kontraktor mbi themelin e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik mund të vijojë me shqyrtimin e plotë të ankesës sonë.

Shqyrtimi i detyrueshëm i ankesave nga autoritetet kontraktore përbën një mekanizëm të detyrueshëm ligjor vetëkorrigjimi brenda procedurës së prokurimit publik, duke u dhënë mundësinë vetë autoriteteve kontraktore të vlerësojnë, korrigjojnë dhe mbajnë qëndrim mbi pretendimet e ngritura nga operatorët ekonomikë.

Nenet 114 dhe 115 të Ligjit “Për Prokurimin Publik” përcaktojnë qartësisht procedurën e shqyrtimit të ankesave nga autoritetet kontraktore dhe, më pas, nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

II.5. Në datën 29.06.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1976/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan nr.2898/6 prot., datë 25.06.2026 me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së nr.2898/5 prot., datë 24.06.2026, për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK. Sipas këtij vendimi rezulton se ankesa e ankimuesit nuk është pranuar pasi është paraqitur jashtë afatit 10 ditor të përcakuar në legjislacionin e prokurimit publik.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

II.1. Në datën 08-06-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr.REF-88936-06-05-2026, me objekt: “Furnizim vendosje e sistemit të dedektimit të zjarrit në pyje”, me fond limit 27,421,733 lekë

pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar me datë 08-07-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

II.2. Në datën 18.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6844, protokolluar me nr. 1976/2026 prot, datë 19.06.2026 e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 29.06.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 21976/1 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues me objekt: “Kundershtime ndaj Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan percjelle me shkresen nr. 2898/5, date 24.06.2026”, ku thuhet shprehimisht si vijon:

“Nga përmbajtja e Vendimit të KSHA-së percjelle me shkresen nr. 2898/5, date 24.06.2026, rezulton se ankesa e OE-së nuk është marrë në shqyrtim, me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimit.

Konkretisht, KSHA shprehet se, në zbatim të:

(i) nenit 110, pikat 1, 7 dhe 8, “Afatet për ankimim”, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”;

(ii) nenit 97, pika 1, germa “a”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021; afati i ankimit për këtë procedurë, e cila klasifikohet “mbi kufirin e lartë monetar”, është 10 ditë, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Kundershtim:

Aktualisht, njoftimi i kontratës mban datën 08.06.2026, ndërsa ankimi i OE-së është dorëzuar më datë 18.06.2026, fakt ky i konfirmuar edhe nga vetë KSHA.

Nëse arsyetimi i KSHA-së ka qenë se afati i ankimit duhet të fillonte nga momenti i publikimit të njoftimit dhe jo nga dita pasardhëse, sqarojmë se çështja e nisjes së afateve të ankimit është tashmë ezauruar përmes qëndrimeve unifikuese të Komisionit të Prokurimit Publik. Ky i fundit është shprehur qartësisht se “afatet e ankimit nisin nga e nesërmja e datës së publikimit”.

Për referencë, mund të konsultohet Vendimi Interpretues i KPP-së nr. 169/2026, paragrafët III.1.12 dhe III.1.13, faqe 15-16.

Kërkesë:

Kujtojmë se mekanizmi i shqyrtimit të ankesave në një procedurë prokurimi publik bazohet në një sistem vlerësimi me dy shkallë administrative.

Shkalla e parë konsiston në shqyrtimin e ankesës nga vetë strukturat përgjegjëse/eprore të autoritetit kontraktor, konkretisht Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (Neni 114 i LPP);

dhe Shkalla e dytë konsiston në shqyrtimin e ankesës, si dhe të vlerësimit të bërë mbi të nga autoriteti kontraktor/KSHA, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik (Neni 115 i LPP).

Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka rrëzuar ankimin për arsye procedurale, konkretisht për tejkalim të afatit të ankimit, vlerësim ky që është në kundërshtim me ligjin dhe praktikën interpretuese të KPP-së, si dhe nuk ka marrë në shqyrtim të gjithë elementët përbërës dhe pretendimet materiale të ankesës, gjykojmë se Komisioni i Prokurimit Publik duhet fillimisht ta kthejë ankimin për shqyrtim të detyrueshëm pranë autoritetit kontraktor.

Vetëm pas administrimit të qëndrimit të autoritetit kontraktor mbi themelin e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik mund të vijojë me shqyrtimin e plotë të ankesës sonë.

Shqyrtimi i detyrueshëm i ankesave nga autoritetet kontraktore përbën një mekanizëm të detyrueshëm ligjor vetëkorrigjimi brenda procedurës së prokurimit publik, duke u dhënë mundësinë vetë autoriteteve kontraktore të vlerësojnë, korrigjojnë dhe mbajnë qëndrim mbi pretendimet e ngritura nga operatorët ekonomikë.

Nenet 114 dhe 115 të Ligjit “Për Prokurimin Publik” përcaktojnë qartësisht procedurën e shqyrtimit të ankesave nga autoritetet kontraktore dhe, më pas, nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

Gjithashtu në datën 29.06.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1976/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan nr.2898/6 prot., datë 25.06.2026 me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së nr.2898/5 prot., datë 24.06.2026, për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK. Sipas këtij vendimi rezulton se ankesa e ankimesit nuk është pranuar pasi është paraqitur jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në legjislacionin e prokurimit publik.

II.5. Neni 24, pika 1, “Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

II.6. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

II.7. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

II.8. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

II.9. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

II.10. Në nenin 97 “Afatet për paraqitjen e ankesave”, të VKM-së nr 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, është parashikuar shprehimisht si vijon:

1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anullimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

3. Në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, në procedurat e prokurimit me faza, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/ entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

4. Në rastin e ankesave për lidhjen e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me disa operatorë ekonomikë, pas procedurave për rihapjen e konkurrimit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”

II.11. Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të kontratës 08.06.2026, ka qenë brenda 10 ditëve, nga data e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës. Në këtë kuadër, ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur në datë 18.06.2026, pra brenda afateve të ankimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në rastin konkret, ankesa e operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se është dorëzuar brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 1 e LPP i cili parashikon, se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të

ankimimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj nuk përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik rritet bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Autoriteti kontraktor të marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr.REF-88936-06-05-2026, me objekt: “Furnizim vendosje e sistemit të dedektimit të zjarrit në pyje”, me fond limit 27,421,733 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 08-07-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.
2. Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi hartimin dhe argumentimin e kërkesave për kualifikim e specifikimeve teknike, të jepen argumentimet përkatëse lidhur me pretendimet e shoqërisë “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK si dhe të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për trajtimin e ankesës.
3. I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

